



Nr. 01/23

Datë: 01.02.2023

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të vendimit nr. 47/22 të Këshillit Mësimor Shkencor të FSI-së, si dhe në mbështetje të vendimit nr. 34/23 të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, FSI miratoi këtë:

Rregullore për Kodin e Etikës në FSI

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Ky draft i Rregullores për Kodin e Etikës është nxjerr duke u bazuar në parimet bazë të parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë, Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Statutin e Fakultetit, për të siguruar një kornizë të rregullave të sjelljes së personelit akademik, administrativ dhe studentëve, sipas normave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të Fakultetit dhe me lirinë akademike, krijimit të mundësive të barabarta për personelin akademik, administrativ dhe studentët (e Fakultetit) për të përmirësuar klimën organizative dhe mjedisin e punës. FSI vepron në bazë të mësimave të Kuranit e të Sunetit të rregullave të nxjerra prej tyre në bazë të shkollës juridike hanefite.

Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në FSI, duke përfshirë personelin akademik, administrativ dhe studentët, si dhe të gjithë personat tjerë që në ndonjë formë a tjetër janë të lidhur me Fakultetin.

Neni 3

Emërtimet

1. Plagjiatura nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimit të idesë, rezultateve, punimit të shkruar a të ndonjë forme tjetër në tërësi ose edhe pjesërisht, pa e treguar burimin e shfrytëzuar dhe pa pasur asnjë meritë për të njëjtat.
2. Autorësia e një vepre punimi shkencor ose profesional i nënshkrohet një rregulli rigoroz etik: “Është pronësi, e cila as nuk mund të përvetësohet pa kontribut, por as të bartet te autorë të tjerë formalisht”. Të gjithë anëtarët e Fakultetit, të cilët marrin pjesë në punën kërkimore duhet të garantojnë burimin e të dhënave të publikuara dhe autorësinë e tyre, duke filluar nga ideja e veprës deri në dhënien e informacionit.
3. Interesi privat i një anëtari të Fakultetit, jo vetëm i natyrës ekonomike, mund të lidhet me:
 - 3.1 Interesin e drejtpërdrejtë të personit në cilësinë e tij si anëtar i Fakultetit, interesin e një anëtari të familjes së një anëtari të Fakultetit;
 - 3.2 Interesin e institucioneve dhe kompanive, personave fizik dhe juridik me të cilët një anëtar i fakultetit ka marrëdhënie punë apo raporte ekonomike;
 - 3.3 interesin e një institucioni, kompanie apo personi juridik, kur ai/ajo kontrollohet nga një anëtar i fakultetit apo kur ky posedon një pjesë të konsiderueshme financiare;
 - 3.4 interesin e palës së tretë, kur përmes saj, një anëtar i të fakultetit me qëllim i bëhet favor.
4. Të dhënat me statusin konfidencial janë ato të dhëna të cilat janë të besuara për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të fakultetit dhe të cilat me ligj dhe rregulloret e fakultetit janë vlerësuar si konfidenciale.
5. Komisioni i Etikës është një organ profesional i Këshillit të Fakultetit, i cili themelohet me propozim të dekanit dhe është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur shkelen rregullat e Kodit Etik nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e Fakultetit.
6. Komisioni Disiplinor, është organ profesional i themeluar nga dekani i Fakultetit, i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rast kur bëhet shkelje e Kodit të Etikës nga ana e studentëve të fakultetit.

Neni 4

Parimet bazë

4.1 Të drejtat e garantuara

Ky Kod i Etikës garanton respektimin e të drejtave universale siç janë: ndershmëria, morali, etika, respekti, përgjegjshmëria, përgjegjësia, drejtësia, korrektësia, solidariteti, përkushtimi, transparenca, virtyti dhe toleranca.

4.2 Respektimi i integritetit dhe dinjitetit të personelit të fakultetit

1. Anëtarët e fakultetit janë të obliguar që të respektojnë integritetin dhe dinjitetin personal dhe profesional të secilit punëtor të fakultetit.
2. Gjatë veprimeve të përditshme, çdo anëtar i fakultetit duhet të jetë bashkëveprues, komunikues, të respektojë normat e edukatës qytetare, duke shmangur çdo sjellje apo veprim mospërfillës apo arrogant.
3. Anëtarët e Fakultetit janë të obliguar që të kontribuojnë në krijimin e atmosferës bashkëpunuese, tolerancës dhe vlerave morale.

4.3 Parimi i autonomisë në fakultet

1. Anëtarët e fakultetit janë të obliguar që të ruajnë pavarësinë e vet si vlerë themelore të punës shkencore dhe t'i kundërvihen çdo përpjekje që vjen jashtë fakultetit për imponim të ideve ose orientimeve ideologjike të cilat dëmtojnë misionin fisnik të Fakultetit dhe parimet e tij, të cilat nuk kanë të bëjnë me qëllimin dhe thirrjen e së vërtetës shkencore dhe rregullave profesionale. Anëtarët e Fakultetit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete ose paraqitje të tjera të cilat dëmtojnë imazhin e Fakultetit. Anëtarët e fakultetit nuk duhet të prononcohen apo të përcjellin informacione të pasaktë të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e fakultetit. Anëtarët e fakultetit duhet të respektojnë emrin e mirë të fakultetit dhe nuk guxojnë të dëmtojnë reputacionin e tij. Anëtarët e fakultetit nuk mund të përdorin pa autorizim emrin dhe logon e fakultetit, gjatë paraqitjes publike.

4.4 Parimi i lirisë akademike

1. Fakulteti i Studimeve Islame promovon lirinë dhe autonominë individuale si parakusht për studim, mësim, profesionalizëm, kërkime profesionale dhe shkencore gjithëpërfshirëse.
2. Anëtarët e fakultetit duhet të sillen me ndershmëri dhe me përgjegjësi gjatë ushtrimit të lirisë akademike, në mënyrë që metodat, rezultatet, integritetin dhe implikimet etike të kërkimit t'ua paraqesin komunitetit shkencor dhe shoqërisë.

3. Anëtarët e fakultetit do të respektojnë dhe zbatojnë vendimet akademike dhe ato të administratës të cilat i shërbejnë efikasitetit, barazisë, paanshmërisë dhe transparencës së veprimtarive institucionale të Fakultetit.

4.5 Parimi i respektimit të ligjeve dhe rregulloreve

Çdo anëtar i fakultetit është i detyruar të punojë, studiojë dhe veprojë në përputhje me dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë, Kushtetues së BIK-ut, Statutit, rregulloreve dhe akteve të tjera të institucionit.

4.6 Parimi i ndalimit të diskriminimit

1. Fakulteti duhet t'u japë mundësi të barabartë çdo personi gjatë procesit të punësimit, emërimit, promovimit, pagesave, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në fakultet pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre dhe moshe; përderisa ai nuk bie ndesh me parimet e institucionit.

2. Ndalohet çdo veprim denigrues, bullizmi, përqeshja, nënçmimi ndaj çdo anëtari të fakultetit.

3. Komunikimet profesor-student, që ndërlihen me procesin mësimor, në situatat normale kufizohen në hapësirat e fakultetit.

Neni 5

Praktikat e ndaluara në procesin mësimor

1. Studentëve u ndalohet përshkrimi apo kopjimi i çdo forme gjatë kryerjes së obligimeve që dalin në kuadër të procesit mësimor; provime, detyra, seminare, si dhe me rastin kur ata i nënshtrohen vlerësimit të dijes ose njohurive.

2. Me kopjim nënkuptohet edhe pranimi ose dhënia e ndihmës, e cila ka ndikim në objektivitetin dhe korrektësinë e vlerësimit të punës së të punësuarve në fakultet.

3. Të gjithë anëtarëve të fakultetit ju ndalohet mbështetja ose çfarëdo ndihme që ka të bëjë me kopjimin.

4. Gjatë testeve të njohurive ndalohet përdorimi i telefonave dhe i mjeteve të tjera teknologjike.

Neni 6

Shfrytëzimi i njerëzve në punën kërkimore shkencore dhe profesionale

1. Nuk është i lejuar kërkimi, i cili mund të rezultojë me rrezikshmëri të lartë të lëndimeve fizike ose psikologjike, por edhe nëse të njëjtët kanë ndikim negativ në mjedis.

2. Nuk lejohet as mbështetja apo ndihma eventuale e anëtarëve tjerë të fakultetit në këto aktivitete kërkimore me ndikime negative.

3. Gjatë kërkimit shkencor duhet të aplikohen parimet e marrëveshjeve reciproke të pjesëmarrësve në procesin e kërkimit shkencor. Të drejtat dhe dinjiteti i pjesëmarrësve në procesin e kërkimit shkencor duhet të mbrohen në mënyrë adekuate.

4. Nëse anëtarët e fakultetit e zhvillojnë mësimin ose praktikën aty ku janë të pranishëm edhe fëmijët, atëherë, krahas parimeve të tjera, duhet të respektohen edhe standardet ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve.

Neni 7

Fabrikimi dhe falsifikimi i rezultateve

1. Në punën kërkimore shkencore nuk lejohet fabrikimi dhe falsifikimi i të dhënave dhe rezultateve.

2. Fabrikimi i të dhënave ose rezultateve gjatë fazave të caktuara të procesit kërkimor është lëndim shumë i rëndë i etikës shkencore. Me fabrikim mendohet në paraqitjen e trilluar, sajimin dhe shpifjen e të dhënave që nga marrja e mostrave, aplikimin e metodave shkencore, shfrytëzimin e pajisjeve joadekuate, edhe pse është e njohur se kërkimi shkencor nuk i ka fituar ato të dhëna.

3. Falsifikimi nënkupton çdo veprim, i cili bie ndesh me parimet e etikës shkencore duke falsifikuar, shtrembëruar qëllimisht me rezultatet në të gjitha ose në një nga fazat e kërkimit shkencor objektin, metodat, pajisjet dhe proceset.

Neni 8

Plagjiatura

1. Plagjiatura e çdo forme e punimeve dhe ideve është lëndim më i madh i etikës shkencore dhe profesionale, pra i Kodit të Etikës.

2. Pandershmëria shkencore është edhe vetë plagjiatura, përsëritja e ideve, të dhënave dhe rezultateve, të cilat janë publikuar më herët nga i njëjti autor. Vetë plagjiaturë është edhe rasti kur informacioni i njëjtë botohet në revista të ndryshme shkencore, me qëllim që të rritet numri i punimeve të publikuara.

3. Të gjitha botimet e mbështetura nga fakultetit, siç janë librat, revistat dhe punimet e diplomave të nivelit MA do t'i nënshtrohen sistemit kundër plagjiaturë "TURNITIN" ose të ngjashme.

4. Nëse një punim, qoftë ai libër, punim diplome apo punim shkencor, rezulton të jetë plagjiaturë apo bartje nga punimet tjera në sasinë 15 % e më shumë, atëherë ai punim anulohet.

Neni 9

Autorësia

1. Nga anëtarët e punësuar në fakultet, kërkohet që të vendosin si autorë vetëm ata persona që kanë marrë pjesë në procesin kërkimor dhe të cilët kanë dhënë kontribut intelektual në hartimin e veprës shkencore dhe profesionale.

2. Autor i një vepre shkencore dhe profesionale nuk mund të jenë personat, të cilët: vetëm e kanë financuar kërkimin; e kanë siguruar literaturën; janë vetëm drejtues të institucionit ku është kryer kërkimi shkencor, apo ata të cilët kanë ndihmuar nga aspekti teknik, kolegët, miqtë, anëtarët e familjes etj.

Neni 10

Falsifikimi dhe rirregullimi i rekomandimeve

1. Falsifikimi dhe manipulimi i shkresave, rekomandimeve dhe dokumenteve zyrtare të fakultetit, përdorimi i dokumenteve dhe të dhënave zyrtare të fakultetit për qëllim keqinterpretimi, është lëndim i Kodit të Etikës.

2. Prezantimi jo i drejtë i të arriturave akademike në dokumente të shkruara ose mënyra të tjera të komunikimit, është i ndaluar dhe është shkelje e parimeve etike (zgjedhja në thirrje, formimi i komisioneve jo kompetente, pranimi i tezave të masterit dhe doktoratës pa bazë shkencore, paraqitja e thirrjes akademike dhe shkencore të cilën nuk e disponon).

Neni 11

Pranimi i dhuratave

Anëtarët e fakultetit nuk mund të kërkojnë apo pranojnë ndonjë dhuratë apo përfitim qoftë edhe të natyrës simbolike, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi mund të ndikojë në aktivitetin e tyre në fakultet. Vlera e saj nuk guxon të tejkalojë shumë e pesëdhjetë (50) euro, ose zyrtari nuk mund të pranojë dhuratë të rastit, vlera e përgjithshme e të cilave kalon mbi pesëqind (500) euro brenda vitit.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Kur ndodh një konflikt i interesit, anëtari i fakultetit duhet që menjëherë të informojë organin/personin kompetent dhe vetë të përmbahet nga zgjidhjet dhe vendimet.
2. Një konflikt i interesit ndodh kur interesi privat i një anëtari të fakultetit, me përjashtim të studentëve, është në kundërshtim real ose potencial me interesat jo vetëm ekonomike të fakultetit. Ky konflikt ka të bëjë edhe me raportet e punës në institucione arsimore apo universitete tjera që konsiderohen si konkurrent potencial.

Neni 13

Nepotizmi, favorizimet dhe keqpërdorimi i pozicionit personal

1. Fakulteti nuk toleron asnjë formë të nepotizmit dhe të favorizimit, sepse kjo është e papajtueshme me dinjitetin njerëzor, me njohjen e drejtë të paanshme të mundësive dhe njohurive, ndershmërinë, integritetin, profesionalizmin, lirinë akademik. Drejtësinë, paanësinë dhe transparencën. Fakulteti kërkon nga profesorët, hulumtuesit dhe çdo anëtar tjetër i fakultetit që të përmbahet nga një praktikë e tillë.
2. Nepotizmi është kur një profesor, një studiues, apo një anëtar i personelit administrativ apo teknik, drejtpërdrejt ose tërthorazi madje, edhe duke përdorur financimet e palës së tretë përdor reputacionin ose aftësinë e tij bindëse për të ofruar favore, për të përshtatur shpalljet dhe kontratat e punës, për të cilat kanë të bëjnë me fillimin apo vazhdimin e karrierës universitare (kjo i prekë edhe bursat dhe kontratat), si dhe pranimin e fëmijëve, pjesëtarët e familjeve dhe të afërmeve.
3. Si nepotizëm konsiderohen edhe favorret e një profesori ndaj studentëve të tij. Kjo sjellje është e papajtueshme me vlerat e ndershmërisë dhe paanësisë, si dhe me interesat dhe karrierën e kandidatëve meritator.
4. Anëtarët e fakultetit nuk mundën, direkt ose indirekt, të përdorin pozitën e tyre akademike ose zyrtare për të urdhëruar anëtarët e universitetit për të përfutur në të mirën e tyre, përveç nëse nuk është fjala për ndonjë detyrim ligjor ndaj tyre. Abuzimi, gjithashtu, ekziston kur sjellja nuk përbën një akt të paligjshëm, por ka papajtueshmëri të dukshme me frymën e rregullave dhe rregulloreve të fakultetit.

Neni 14

Transparenca dhe konfidencialiteti

1. Fakulteti promovon dhe mbështetë transparencën dhe konfidencialitetin në dokumentet e tij dhe veprimtarinë e anëtarëve të tij, si një nga vlerat elementare.

1.1. Të gjithë anëtarët e fakultetit duhet të respektojnë transparencën dhe qasjen në kriteret dhe metodat e vlerësimit gjatë punës profesionale regjistrimi, ngritja profesionale, etj.

2. Të gjithë anëtarët e fakultetit, të cilët, në bazë të detyrave të punës, brenda fakultetit disponojnë me të dhëna të cilat kanë statusin e të dhënave konfidenciale, duhet të mundësojnë mbrojtjen e tyre.

Neni 15

Ngritja profesionale

1. Fakulteti i Studimeve Islame duhet t'i japë mundësi të barabartë çdo personi gjatë proceseve të ndryshme të rekrutimit, emërimit, promovimit, trajnimit apo avancimit në fakultet pa marrë parasysh gjininë, shtetësinë, origjinën etnike e sociale, gjendjen shëndetësore, gjuhën, shtresën shoqërore dhe pozitën e tij në fakultet.

2. Detyra dhe obligimi i mësimdhënësve është që të angazhohet për përtëritjen e kuadrit kërkimor dhe mësimdhënës.

Neni 16

Përdorimi i burimeve të Fakultetit

1. Anëtarët e fakultetit duhet të përdorin resurset e fakultetit me përgjegjësi, kujdes dhe arsyeshmëri, në atë mënyrë që shpenzimet e justifikuara dhe me kërkesë të fakultetit të dëshmohen përmes dokumenteve apo mbajtjes së llogarisë.

2. Pa lejen e qartë të fakultetit, asnjë anëtar i fakultetit nuk i lejohet të përdorë objektet, hapësirat, burimet njerëzore, materialet, hardwerat ose softwerat, apo burimet financiare të fakultetit, personalisht ose përmes lejimit të palëve të treta, personave apo institucioneve për qëllime tjera nga ato institucionale të fakultetit.

Neni 17

Detyrat e Përgjithshme

Të gjitha organet e fakultetit janë të obliguara që secila në kuadër të autorizimeve të tyre të kujdeset për aplikimin dhe avancimin e standardeve etike në fakultet dhe zbatimin e Kodit Etik.

Neni 18

Përgjegjësia për shkeljen e Kodit të Etikës

1. Mosrespektimi i parimeve të këtij kodi, gjegjësisht, shkelja e këtyre parimeve paraqesin lëndimin e ndershmërisë dhe detyrave të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, studentëve, personelit administrativ dhe të tjerëve të lidhur me fakultetin, për të cilën, të njëjtit duhet të mbajnë përgjegjësi.
2. Zgjidhjen e denoncimeve ose raporteve për shkeljen e Kodit Etik e bëjnë organet për zbatimin e Kodit Etik të fakultetit.

Neni 19

Organet për zbatimin e Kodit të Etikës

1. Organet, të cilat kanë kompetencë për zbatimin e Kodit Etik të Fakultetit, janë:
 - 1.1. Komisioni i Etikës, i cili zgjidhet nga KMSH i Fakultetit.
 - 1.2. Komisioni Disiplinor, i cili zgjidhet nga KMSH i Fakultetit.
 - 1.3. Komisioni Disiplinor ad-hoc, i caktuar nga dekani i Fakultetit.

Neni 20

Komisioni i Etikës

1. Komisionin e Etikës e përbëjnë: katër anëtar nga stafi akademik; tre nga stafi i rregullt një nga stafi me angazhim, dhe përfaqësuesi i Unionit të Studentëve. Mandati i stafit të rregullt është katër vjeçar, ndërsa mandati i stafit me angazhim dhe studentit një vjeçar.
2. Kryetari i Komisionit të Etikës zgjidhet nga anëtarët e Komisionit dhe ka mandat katër vjeçar.
3. Komisioni i Etikës mund të nxjerrë Rregulloren e punës, me të cilën do t'i rregullojë çështjet të cilat nuk janë paraparë me këtë Kod.

Neni 21

Komisioni Disiplinor

Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe një nga anëtarët zgjidhet nga radhët e stafit akademik ose bashkëpunëtorët e fakultetit me mandat katër vjeçar, ndërsa një anëtar nga Unioni i Studentëve me mandat një vjeçar.

Neni 22

Komisioni Disiplinor ad-hoc

Komisioni Disiplinor ad-hoc është organ, i cili themelohet me vendim të dekanit të Fakultetit i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur Kodi Etik është shkelur nga të punësuarit jashtë procesit mësimor në dekanatin e Fakultetit.

Neni 23

Fillimi i procedurave

1. Procedurat për vërtetësinë e shkeljes së ndonjë parimi të Kodit Etik të Fakultetit, mund të fillohen me dorëzimin e fletëparaqitjes për shkelje të Kodit, në formë të shkruar, te organet për zbatimin e Kodit, nga neni 17 i Kodit Etik.
2. Fletëparaqitjen për shkeljen e Kodit të Etikës mund ta dorëzojnë të gjithë të punësuarit, por e njëjta duhet të jetë e arsyetuar me të gjitha të dhënat dhe dëshmitë për personat, kohën, vendin, dëshmitarët eventual dhe të jetë e nënshkruar nga bartësi i fletëparaqitjes.
3. Organi për zbatimin e Kodit Etik nga neni 17 i Kodit, nuk do t'i marrë në shqyrtim fletëparaqitjet anonime.

Neni 24

Procedurat e punës së Komisionit të Etikës dhe afatet

1. Në bazë të fletëparaqitjes për shkeljet e parimeve etike nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët, sipas kriterëve të nenit 20, kryetari i Komisionit të Etikës thërret mbledhjen e Komisionit në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e pranimit të fletëparaqitjes.
2. Nëse Komisioni i Etikës vërteton mosekzistimin e shkeljeve të parimeve nga ana e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve, me një vendim të saj e refuzon fletëparaqitjen si të pabazuar.

3. Nëse Komisioni i Etikës e vërteton se është bërë shkelje e ndonjë prej parimeve të Kodit Etik, ai me një vendim i propozon KMSH-së masën përkatëse e cila është: vërejtje me shkrim ose vërejtje publike. Në rast se, këto shkelje bëhen të përsëritura, Komisioni i Etikës i propozon autoritetit drejtues (KMSH-së) ndëshkime të tjera më të rrepta.
4. Për shkeljen e Kodit të Etikës, sipas rastit, Komisioni i Etikës propozon masa disiplinore nga marrja e thirrjeve deri në largimin nga puna.
5. Nëse Komisioni i Etikës e vërteton se shkeljet e ndonjë prej parimeve të Kodit të Etikës nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e fakultetit bie në kundërshtim me Kushtetutën e BIK-ut, Ligjin e Punës dhe Statutin e Fakultetit, ai i propozon masat në harmoni me Kushtetutën e BIK-ut, rregulloret e punës së fakultetit dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë.
6. Vendimet e Komisionit të Etikës merren me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm.

Neni 25

Procedurat e Komisionit Disiplinor dhe afatet

Procedurat e Komisionit Disiplinor, të themeluara nga KMSH i fakultetit, zbatohen në harmoni me rregullat e Statutit të Fakultetit dhe aktet tjera normative.

Neni 26

Procedurat e Komisionit Disiplinor ad-hoc dhe afatet

1. Në bazë të fletëparaqitjes së dorëzuar rreth shkeljes së ndonjë prej parimeve të Kodit Etik nga personeli jo akademik i Fakultetit, komisioni i emëruar ad-hoc fillon procedurat për vërtetësinë e shkeljeve të parimeve etike të Kodit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e marrjes së fletëparaqitjes.
2. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se nuk ka shkelje të parimeve të Kodit Etik të fakultetit, ai me një vendim e refuzon fletëparaqitjen si të pabazuar.
3. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se janë shkelur parimet etike të Kodit, atëherë i propozon dekanit, masat si: vërejtje me shkrim, vërejtje publike.
4. Nëse Komisioni ad-hoc vërteton se janë shkelur parimet etike të Kodit Etik, të cilat bien në kundërshtim me Ligjin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Statutin e Fakultetit, atëherë komisioni u propozon organeve përkatëse fillimin e procedurave disiplinore sipas akteve ligjore të lartpërmendura.

Neni 27

Vendimi i KMSH-së dhe dekanit

1. Vendimi i KMSH-së i sjellë në bazë të propozimit të Komisionit të Etikës për masën e propozuar nga neni 24 i Kodit të Etikës, është përfundimtar.
2. Vendimi i dekanit të Fakultetit i sjellë në bazë të propozimit të Komisionit Disiplinor dhe Komisionit ad-hoc, për masën e propozuar nga neni 25 dhe neni 26 i Kodit të Etikës është përfundimtar.

Neni 28

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Interpretimin e Kodit të Etikës e bën Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit
2. Rregullorja e Kodit Etik diskutohet nga ana e anëtarëve të KMSH-së para se të aprovohet nga Kryesia e BIRK-ut
3. Dekani i Fakultetit duhet t'i propozojë KMSH-së për miratim listën e anëtarëve të Komisionit të Etikës, brenda një muaji nga dita e miratimit të këtij kodi.
4. Kodi Etik hyn në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kryesisë së BIRK-ut dhe i njëjti lajmërohet në web-faqen e fakultetit dhe bëhet publik për anëtarët e fakultetit.

Prishtinë,

01.02.2023

DEKANI



Prof. asoc. dr. Islam Hasani